

---

RELACION JOTEKNIK

---

Konsultimi me publikun

---

SKENDERI G Sh.p.k,

---

Furnizim me karburant

---

---

Tirane, 2022

---

Ekspert Mjedisi: Elvis Xhaferri



**PERSHKRIMI I PROJEKTIT****Qellimi i projektit**

Subjekti SKENDERI G sh.p.k është e regjistruar ne organet tatimore me nr identifikimi NIPT: **K04004205V** me seli Tirane, Njesia Bashkiake Nr.2, Bulevardi “Zhan D’Ark”, Pallat, Z.K, Nr. 8150, Numer Pasurie 4/285, Kati 1.. Subjekti SKENDERI G sh.p.k do te aplikojte per leje mjedisore te tipit B.

**Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448**

Industriete energjitike ID: 1.7 Gaz natyror aromatic ose GLN, pervec rasteve kur veprimtaria eshte e lidhur me tipin A, ose perzierje e aromave. Dhe ID 1.10 Furnizim me karburant i makinave ne nje stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane.

**Objektivat e aktivitetit**

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore te ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

**Vendodhja dhe karakteristikat fizike te projektit****- Instalimi dhe aktivitetet e tij**

Operatori SKENDERI G sh.p.k do te ushtroje aktivitetin e furnizimit me karburant dhe GLN dhe shitje te nenprodukteve te tyre. Vendi ku ushtrohet aktiviteti eshte ne **Rruga “7 Nentori”, Mezez, Kashar, Tirane**. Me sipërfaqe Totale: 900 m<sup>2</sup>.



Vendndodhja Skenderi G Sh.p.k

Nr.	E	N
1	4396316.11	4579377.58
2	4396331.61	4579361.58
3	4396304.43	4579336.12
4	4396288.79	4579351.71

### Koordinatat ne Gauss-Kruger e vendndodhjes

- **Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi**

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk kërkon përdorim të lendeve të para. Operatori posedon stacion për furnizim të automjeteve. Kapaciteti i projektuar është **40868 litra karburant dhe 12500 litra GLN**. Në këtë aktivitet uji nuk është pjesë e funksionimit. Ai do të përdoret vetëm për nyjet sanitare. Gjithashtu edhe do të shkarkohet në rrjetin e kanalizimeve të zonës. Energjia elektrike do të merret nga rrjeti i zonës në bazë të kontratës që operatori posedon.

- **Burimet e shkarkimeve nga instalimi**

**Shkarkime në ajër** - Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi shkarkime, por mund të kemi cilime të lehta nga mjetet të cilat vijnë për tu furnizuar. Komponente të ciluar mund të citojmë CO, NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>. Zona në fjalë është zonë urbane shumë e frekuentuar. Kështu që gjenerimi i gazeve nga mjetet do të jetë në intervale të shkurtra kohe dhe mund të konsiderohet i papërfillshëm. Duhet të theksojmë edhe faktin se mjetet gjatë furnizimit me lende djegëse fiken.

**Shkarkime në ujë**- Ujërat e nyjeve sanitare do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës.

**Shkarkime në tokë**- Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë shkarkime në tokë, mbetjet të cilat do të gjenerohen si pasojë e aktivitetit të konsumit të punonjësve do të grumbullohen dhe do të depozitohen fillimisht në kontener të mbyllur në ambientet e aktivitetit dhe në fund të çdo dite punë do të largohen për në vendet e përbashkta të administruara nga Pushteti Vendor, ndërsa mbetje nga procesi teknologjik nuk kemi.

**Gjenerimi i zhurmave**- Zona e operimit ka një nivel zhurme goxha të lartë krahasuar me pikat e tjera. Zhvillimi i aktivitetit mund të ndikojë në një rritje shumë të lehtë të zhurmës për mos thënë që do të jetë e papërfillshme. Brenda aktivitetit nuk do të lejohet renia e burisë.

- **Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes**

Vendi i zhvillimit të aktivitetit disponon të gjithë kapacitetin dhe hapësirën për të operuar pa krijuar ndotje dhe shqetësime, gjithashtu theksojmë se nëse po të njëjtin vend subjekti ka operuar edhe më parë i paisur me Leje Mjedis sipas ligjit në fuqi.

- **Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis**

Shkarkimet që vijnë si pasojë e zhvillimit të aktivitetit nuk mund të konsiderohen ndotëse. Këto shkarkime do të jenë normale, brenda legjisllacionit aktual në fuqi. Operatori do të marrë masa të vazhdueshme për minimizimin sa më të madh të tyre, duke bërë edhe monitorimet përkatëse për

komponentet e cituar ne Anekset e mesiperme. Clirime te lehta ne ajer do te konsiderojme gazet CO, NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, te cilat gjenerohen vetem ne momente shume te shkurtra kohore vetem ne momentin e ndezjes se motorrit te mjetit pasi eshte furnizuar me karburant.

<b>NDIKIME NEGATIVE NE MJEDIS</b>
<b>Rrezatimi Jonizues</b>
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi rrezatime jonizuese.
<b>Vibracionet</b>
Funksionimi i aktivitetit gjeneron vibrime shume te lehta vetem ne rastet kur autobotet transportojne lendet djegese, e cila ndodh vetem ne harqe kohore te shkurtra, gjithashtu edhe ne momentin kur furnizohen mjete te renda. Keto vibrime jane shume te lehta, nuk ndikojne negativisht ne mjedisin e zones, shqetesimin e banoreve apo bizneseve qe ndodhen ne afersi te aktivitetit.
<b>Ndikimet ne popullsi</b>
Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullise se rajonit ku zhvillohet aktiviteti. Gjate funksionimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullise se rajonit.
<b>Ndikimet ne toke</b>
Aktiviteti i furnizimit me nafte, benzine dhe shitja e nenprodukteve te tyre nuk gjeneron shkarkime ne toke.
<b>Mbetjet e ngurta</b>
Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat i aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga Pushteti Vendor. Kompania do te punoje per ndarjen e tyre qe ne vendburim, nepermjet konteniereve me ngjyra.
<b>Ndikimet ne ajer</b>
Referuar natyres se aktivitetit mund te kemi ndikime negative ne ajer. Clirime minimale ne ajer, mund te kemi vetem ne momentin e ndezjes se mjeteve pas furnizimit me karburant, megjithate ne pikepamjen mjedisore dhe shendetesore keto ndikime mund te konsiderohen te paperfillshme.
<b>Ndikimet ne ujera</b>
Funksionimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne ujera. Ne ujera do te kemi vetem shkarkimin nga nyjet sanitare te cilat do te shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te zones.
<b>Ndikimet ne klime</b>
Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

<b>Ndikimet ne floren dhe faunen</b>
Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë urbane dhe nuk mund të analizojmë ndikime në flore dhe faunë. Operatori do të shtojë sipërfaqet e gjelbërta për një pamje vizuale më të kënaqshme për syrin dhe për të mirat në pikepamjen mjedisore.
<b>Ndikimet nga zhurmat</b>
Zona në të cilën zhvillohet aktiviteti është një zonë urbane shumë e frekuentuar. Për këtë arsye zhurma është prezente në çdo orë të ditës nga qarkullimi rrugor i makinave ashtu edhe nga ai njëjzor. Nga funksionimi i aktivitetit nuk pritet të ketë rritje të nivelit të zhurmave, aq më tepër ndikime negative në këtë prizem.
<b>Ndikimet e aktivitetit të zhvillimit në rruget lokale dhe transportin</b>
Infrastruktura në të gjithë perimetrin e aktivitetit është e shtruar gjithashtu edhe rruga kryesore që kalon pranë aktivitetit. Nuk pritet që të ketë ndikime negative apo ndryshime të infrastruktures.
<b>Ndikimet e aktivitetit të zhvillimit mbi ndertimet, trashëgimë arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura</b>
Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime lidhur me trashëgimë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njëjzore. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar këtë aktivitet.
<b>Ndikime në rrjetin hidrografik</b>
Natyrë e aktivitetit nuk kërkon përdorim të ujit. Përdorimi i ujit që do të përdoret për nyjet sanitare do të kryhet nga rrjeti publik dhe do të shkarkohet në rrjetin e kanalizimeve të zonës.
<b>Ndikimi social-ekonomik</b>
Me operimin e këtij aktiviteti pritet të ketë një impakt pozitiv në ekonominë e vendit, në aspektin e punësimit.

- **Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme**
  1. Teknikat më të mira të disponueshme " (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre të veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve të percaktuara për të parandaluar dhe ku nuk është e praktikueshme, në përgjithësi për të reduktuar emetimet dhe ndikimin i tyre në mjedis në tërësi:
  2. 'Teknika' përfshin të dyja si teknologjinë e përdorur dhe mënyrën në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar.
  3. Teknikat më të mira të disponueshme' do të thotë ato që janë të zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomike dhe teknike të zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur

ose prodhuar teknikat brenda territorit të Pales në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft të lejueshme për operatorin;

4. Me të mirë 'do të thotë më efektiv në arritjen e një niveli të përgjithshëm të lartë të mbrojtjes së mjedisit në tërësi. Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi, ose në raste të veçanta faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot me të mundshme dhe perfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit:
5. Proceset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qenë provuar me sukses në një shkallë industriale;
6. Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të të kuptuarit;
7. Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;
8. Datat e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;
9. Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;
10. Konsumi dhe natyra e lëndëve (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë;
11. Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;
12. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin. Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore;
13. Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet për të;
14. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin. Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçantë, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore;

- **Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur**

Aktiviteti është ekzistues dhe që ne fillim ka qenë ne të njëjten vendndodhje, kjo sepse është në një zonë shumë të frekuentuar e cila sa vjen dhe zhvillohet me shumë. Për këtë arsye edhe fitimet ekonomike arrijnë targetin që kompania i ka vendosur vetes. Teknologjia është bashkohore dhe cilësia e hidrokarburit është e lartë, duke rritur fluksin e punës.

- **Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme)**

1. Grumbullimi i mbetjeve urbane në konteniere të posaçem dhe hermetik për të evituar aromën dhe pakëndshme sidomos në periudhë reshesh dhe thatësire.
2. Diferencimi i mbetjeve të ardhura nga aktiviteti i punonjësve që në burim në kosha me ngjyra.
3. Depozitimi periodik në vendet e përbashkëta që administrohen dhe terhiqen nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
4. Mbajtja e regjistrave për sasine të mbetjeve të gjeneruara dhe depozitimi i tyre në harqe kohore 6-mujore në instancat shtetërore përkatëse.

- **Masat për përdorimin eficient të energjisë**

1. Auditimi vjetor, nga auditues ne procese per evidentimin e perdorimit eficient te energjise.
2. Kualidimi i vazhduar i impianteve.
3. Vleresimi nga menaxheri i energjise per gjendjen e impiantit dhe vleresimit i pjeseve me te reja.
4. Vendosja apo zevendesimi i pajisjeve jo me vone se 2 vjet pas perfundimeve te dala nga Audituesi i Energjise.

- **Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:**

Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre

#### **Detyrimet e punëdhënësit**

- Punëdhënësi vetë ose personi përgjegjes që ka ngarkuar, duhet t'u bëjë të ditur punëmarrësve:
- Specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet që do të perdoren.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës, ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

#### **Përveç sa më sipër punëdhënësi ka detyrë që:**

- Të sigurojë për çdo rast ndihmen e parë mjeksore.
- Të vendos në territorin e instalimit, në vende të dukshme tabelat me rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.
- Të bëjë instruktimin periodik të punonjësve dhe të plotësoj për këtë qëllim formularët bazë të përcaktuar në rregulloret e sigurimit teknik.

#### **Detyrimet e punëmarrësit**

- Të njoh mirë procesin e punës dhe makinerit apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masa duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë

**Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme**

Natyra e nje aktiviteti te tille nuk preket nga nderprerje sezonale. Per kete arsye nderprerjet definitive do te shoqerohen me zbatimin e planit te cmontimit te instalimit dhe zbatimin e plote te planit te rehabilitimit te mjedisit postfunktionim. Gjithashtu per nderprerje te tilla si pasoje e avarive qe shoqerohen me ndotje te tipeve te ndryshme duhet te njoftohen instancat shtetetore. Megjithate aktivitetit nuk parashikon nderpreje apo mbyllje te aktivitetit.

- **Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.**

Qëllimet e monitorimit mjedisor Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur



vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë. Është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

**Objektivat e Monitorimit:**

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e prodhimit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga faktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar

<b>Monitorimi i Planifikuar</b>	
Monitorimi i parametrave mjedisore (ajer dhe zhurmë)	Cdo 6 muaj
Monitorimi i papershkrueshmerise se depozitave	Periodik
Monitorimi i trajnimeve te stafit ne raste emergjente	Cdo 6 muaj-1 vit
Monitorimi i gjendjes mekanike te pajisjeve operuese	Cdo dite nga punonjesi i impiantit  Cdo 1 muaj nga mekanike te posacem
Monitorimi i perdorimit eficient te energjise	Cdo 1 vit nga kompania dhe cdo 2 vjet nga Audituesi i Energjise

